



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Udhëzues i Autoriteti Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) për ofruesit/institucionet për aplikimin në proceset e Validimit dhe Akreditimit (V&A) si dhe informata rreth procedurave të zhvillimit të Standardit të Profesionit (SP)

Standardi i profesionit është parakusht për të hyrë në procesin e validimit dhe akreditimit për të gjithë Ofruesit/Institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (IAAP).

Çdo ofrues që aplikon për këtë proces (V&A), duhet që kualifikimet e tyre të kenë të zhvilluar dhe miratuar Standardin Kombëtar të Profesionit. Nëse ky standard nuk është i zhvilluar dhe miratuar, atëherë ky ofrues duhet të inicioj procesin e zhvillimit të atij standardi duke u bazuar në kriteret e UA nr. 28/2014 për Kriteret dhe Procedurat mbi verifikimit e Standardit të Profesionit.

Ofruesit mund të aplikojnë për procesin e V&A duke u bazuar edhe në standard/kualifikim ndërkombëtar.

Më shume informata rreth këtyre proceseve mund të gjeni më poshtë në këtë udhëzues.

1. Procesi i zhvillimit të Standardit Kombëtar të Profesionit SKP

1.1. Procedurat e aplikimit për zhvillimin e SKP

- **Formati i AKK- së për zhvillimin e Standardit të Profesionit (SP)** ; (format i cili merret tek AKK); *për formatin e AKK ju lutemi kontaktojeni: Bleta Kadriu, email: bleta.kadriu@rks-gov.net*
 - **Udhëzim Administrativ UA nr. 28/2014 për Kriteret dhe Procedurat mbi verifikimit e Standardit të Profesionit dhe Udhëzues për zhvillimin e SP** , (dokumente që ju ndihmojnë në zhvillimin e SP);
 - **Ofruesi/institucioni formon ekipin e ekspertëve të fushës për zhvillimin e SP;**
 - **Pas zhvillimi të SP, ai dokument dërgohet në forme elektronike në MASHT (Këshilli i Arsimit dhe Aftësisimit Profesional dhe për të Rritur “KAAPR”)***
 - **KAAPR përcjell këtë dokument tek AKK për verifikim;**
 - **Verifikimi i SP bëhet nga AKK;**
 - **AKK pas verifikimit të SP përcjell tek KAAPR dhe tek zhvilluesi vendimin e KD-së së bashku me Raportin e jashtëm të verifikimit.**
 - **Zhvilluesi duhet të përmirësoj SP sipas rekomandimeve të vendimit dhe raportit të jashtëm të verifikimit dhe pastaj të përcjellë atë tek AKK.**
-

Procedura zgjatë 3-6 muaj.

Pas kësaj procedure, ofruesi mund të aplikoj për procesin e validimit dhe akreditimit si më poshtë në pikën 2.

**personi kontaktues për KAAPR është Valbona Fetiu Mjeku, email: valbona.fetiu.mjeku@rks-gov.net*

2. Procedura e aplikimit me Standard të Profesionit/Kualifikim ndërkombëtar

- **Marrëveshja me shkrim me zhvilluesin e SP/Kualifikimin për përdorimin e këtij standardi/kualifikimi**
Kjo marrëveshje duhet të jetë e besueshme dhe e qëndrueshme me afat kohorë se paku një cikël të trajnimit/shkollimit.
- **AKK verifikon marrëveshjen me zhvilluesin e SP/Kualifikimit**
Pas kësaj procedure, ofruesi mund të aplikoj për procesin e validimit dhe akreditimit si më poshtë në pikën 3.
(për këtë pike duhet të konsultoheni me zyrtaret e AKK-së se cilat kualifikime mund të përfshihen me standard ndërkombëtar)

3. Procesi i aplikimit për Validim dhe Akreditim

3.1. Procedurat e Validimit dhe Akreditimit (nëse Standardi i Profesionit është i zhvilluar dhe është pjese e listës së SP nga AKK, atëherë ofruesit/institucionet hyjnë direkt në procesin e V&A)

- **Kërkesa drejtuar Këshillit Drejtues të AKK për të hyrë në proces me informata rreth ofruesit dhe kualifikimeve** (*kërkesa nuk ka ndonjë format të veçantë*)
- **Aplikacioni për Validim; (3 kopje fizike**, për secilin kualifikim)
- **Aplikacioni për Akreditim; (3 kopje fizike** për secilin kualifikim)
- **Raporti i Vet vlerësimit (RVV) (3 kopje fizike** për secilin kualifikim) dhe dokumentet tjera të kërkuara në aplikacionet e lartpërmendura (1 **kopje/dosje** e listuar dhe e referuar me dokumente dhe numra sipas kërkesave në aplikacione)
(Formati i RVV duhet të merret tek AKK);
- **Formati i Programit/Trajnimeve** duhet të jete sipas kriterëve të AKK-së; (format i cili merret te AKK); (*dokumentet e lartshënuara duhet të dorëzohen edhe në CD në forme elektronike*).
- **Pagesa e tarifave për validim dhe akreditim;** (Ilogaritjet bëhen pas aplikimit dhe janë të cekura në UA 35-2014)
Procedurat dhe kriteret e këtyre proceseve gjenden në “UA 35-2014 Për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë”
- Kohëzgjatja deri në 6 muaj
- Materialet (aplikacionet) dhe informata tjera i gjeni në <http://akk-ks.net/>

4. Dokumentet e nevojshme për procesin e akreditimit dhe validimit nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) për Institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (IAAP) janë si në vijim: (vetëm 1 kopje për 1 kualifikim)

- Certifikata e regjistrimit nga organi kompetent dhe numri fiskal.
- Dëshmi për pronësinë ose marrjen me qira të objektit me vlefshmëri kohore se paku për

kohën e kërkuar për akreditim.
- Rregullorja e punës dhe kodi i mirësjelljes.
- Kabinetet duhet të jenë të pajisura me pajisje përkatëse për fushat e caktuara dhe hapësira të jetë në përputhshmëri me numrin e nxënësve/kandidatëve.
- Lista e kuadrit/stafit edukativo-arsimor dhe aftësues dhe administrativ (CV, kopje të diplomave dhe certifikatave) dhe kontratat e punës të nënshkruara se paku për kohën e kërkuar për akreditim.
- Plani zhvillimor për veprimtarinë edukativo-arsimore dhe aftësuese dhe plani i biznesit të IAAP për së paku 3 vite.
- Plani financiar /pasqyrat financiare për së paku 3 vite.
- Planprogrami vjetor i punës së IAAP edukativo-arsimor dhe aftësues.
- Planin/rregulloret e institucionit për implementim e Sigurimit të Cilësisë të brendshëm dhe/ose të jashtëm, vendimin për përcaktimin e personit përgjegjës për SC (koordinator për SC).
- Rregullore të brendshme për regjistrimin e kandidateve, (student, nxënës) dhe rregullore për ruajtjen e konfidencialitetit.
- Dokument mbi Politikat zhvillimore të stafit, Analiza e Nevojave për Trajnim, Shqyrtimi i performancës dhe monitorimi i stafit.
- Programet lëndore sipas klasave dhe profileve arsimore dhe aftësuese të aprovuara nga MASHT, ose kualifikimet modulare sipas përmbajtjes strukturore e caktuar nga AKK.
- Lista e teksteve mësimore kryesore dhe alternative që përdoren.
- Lista për pajisjet dhe materialet të cilat janë në dispozicion për ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimit/modulit
- Kopja e kontratës (fletë regjistrimi) ndërmjet IAAP, nxënësit, kandidatit, (prindit ose kujdestaret të fëmijëve) për regjistrim.
- Politikat dhe procedurat për regjistrim dhe përzgjedhje, të dhënat monitoruese, duke përfshirë statistikat e regjistrimit dhe rezultateve të arritura.
- Politikat dhe Procedurat për njohjen e mësimit paraprak, koordinator për NJMP dhe lista e eksperteve të jashtëm për vlerësim (nëse aplikohet)
- Politikat /Procedurat për njohjen e kredive nga institucionet tjera.
- Një mostër e certifikatës duhet t'i bashkëngjitet dosjes se dokumenteve se bashku me një portfolio të kandidatit që nga regjistrimi deri në certifikim.
- Raporti i Vet Vlerësimit (dokument ky i cili duhet të plotësohet nga IAAP duke u udhëzuar/këshilluar nga ekspertet e AKK-së, <i>për formatin e RVV ju lutemi kontaktojeni: Avni Gashi, email: avni.gashi@rks-gov.net dhe Kaltrina Mulliqi email: kaltrina.mulliqi@rks-gov.net</i>
- Formatin e Programit /moduleve sipas kriterëve të AKK-së (format i cili merret te AKK); <i>për formatin e AKK ju lutemi kontaktojeni: Milot Hasangjekaj, email: milot.hasangjekaj@rks-gov.net</i>
- Aplikacionet për Validim dhe Akreditim (aplikacionet mund të merren në ueb faqen e AKK-së: (www.akk-ks.net)).